



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet nga mbledhjet; 26, 27 dhe 28 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/31


Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/31


Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë nr. 05/15 të datës 22 korrik 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.3 e vendimit të Qeverisë nr. 05/15 të datës 22 korrik 2020, për themelimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, kështu që në vend të z. Burim Rreci, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, anëtar, caktohet z. Bekim Hoxha Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Ky vendim paraqet pjesë përbërëse të vendimit të Qeverisë nr. 05/15 të datës 22 korrik 2020.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19, 50 (4), (5) dhe 52 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për Zyrën e Koordinatorit Shtetëror për Dialog me Serbinë

1. Paga e Koordinatorit Shtetëror për Dialog me Serbinë është e barasvlershme me pagën e Zëvendësministrit (sipas praktikave me raste të ngjashme përkatësisht, Vendimi i Qeverisë Nr. 11/73 të datës 5 shkurt 2016).
2. Ndhmësit (asistentët) profesional të përkohshëm të Koordinatorit Shtetëror për Dialog me Serbinë, sipas pikës 10. të Vendimit të Qeverisë 02/09, të datës 1 korrik 2020, kompensohen ngjashëm me pozitën e asistentit/es të Kryeministrit.
3. Koordinator, mund të angazhoj ekspert të përkohshëm për tema specifike, të cilët paguhen sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe kompensimin dhe shpenzimet e udhëtimit duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 07/2004, dhe Vendimit të Ministrit të Financave Nr. 30/2018, të datës 19 qershor 2018 për tarifat e rishikuara për udhëtime jashtë vendit.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:


V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Ndërmintor për Ujërat, si trup koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës, në këtë përbërje:

1.1. Kryeministri i Republikës së Kosovës	Kryesues;
1.2. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit	anëtar;
1.3. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
1.4. Ministria e Financave	anëtare;
1.5. Ministri i Shëndetësisë	anëtar.
2. Këshilli Ndërmintor për Ujëra jep mendime dhe rekomandime për:
 - 2.1. Propozim ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;
 - 2.2. Zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;
 - 2.3. Hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra;
 - 2.4. Zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave;
 - 2.5. Zgjedhjen e politikave financiare nga fusha e ujërave.
3. Këshilli Ndërmintor për Ujërat kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me ligj.
4. Anëtarë të Këshillit pa të drejtë vote janë edhe Përfaqësuesi i Ambasadës Zvicerane (si koordinator i komunitetit të donatorëve në sektorin e ujërave) dhe përfaqësues (me rotacion) të donatorëve aktiv në sektorin e ujërave.
5. Këshilli Ndërmintor për Ujërat do të ketë Sekretariatën e tij i cili do të ndihmojë në kryerjen e punëve dhe obligimeve të Këshillit. Sekretariati përkrah Kryeministrin si Kryesues i Këshillit dhe Ministrat anëtarë përmes këshilltarëve të deleguar nga Qeveria Zvicerane.
6. Sekretariati do të kryej detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara me rregulloren e punës së Këshillit Ndërmintor të Ujërave të miratuar nga Qeveria.

7. Mjetet për shpenzimet e punës të Këshillit Ndërmintor të Ujërave sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga përkrahja e donatorëve.
8. Këshilli Ndërmintor i Ujërave përgatit raporte vjetore të cilat i raporton para Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.
9. Obligohen të gjitha Ministritë e linjës dhe palët e sektorit të ujërave të bashkëpunojnë dhe ta përkrahin Këshillin dhe Sekretariatit e Këshillit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi.
10. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë nr. 03/59 i datës 31 korrik 2018.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej shtatëdhjetë mijë euro (70,000.00 €) në emër të ndihmës për blerjen e librave dhe materialeve tjera shkollore për nevojat e nxënësve të Komunës së Bujanovcit, Komunës së Medvegjës dhe Komunës së Preshevës, në emër të bashkëfinancimit sipas kërkesës së Këshillit Kombëtar Shqipëtar me shkresën Nr. 180/1/20, datë 04.09.2020.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen në organizatën buxhetore Ministria e Financave, me kod 201, në nën programin "Thesari", të kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Thesari i Kosovës që të realizojë transferin e mjeteve në llogarinë e përcaktuar të Këshillit Kombëtar Shqipëtar, sipas pikës 1. dhe 2. të këtij vendimi si dhe shkresës konfirmuese Nr. 181-1-2/20, datë 08.09.2020 me detajet bankare të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Këshilli Kombëtar Shqipëtar do të njoftojë Qeverinë e Republikës së Kosovës pas pranimit dhe përdorimit të mjeteve në bazë të qëllimit sipas kërkesës me Nr. 180/1/20, datë 04.09.2020.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej dyqind mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër euro (200,954.00 €) për pagesën e faturës së primit bruto të sigurimit për muajin Gusht 2020, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të datës 30.07.2020 si dhe Vendimit Nr. 06/24 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 14.08.2020.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike", përkatësisht nën-programi "Kompensimi i Kartonit të Gjëlber" me kod 29700, kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere dhe transferohen te nën-programi "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere.
3. Autorizohet Ministria e Financave dhe Thesari që bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 30.07.2020 si dhe Vendimit Nr. 06/24 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 14.08.2020, në bazë të procedurës së njëjtë sipas pikës 2. të këtij vendimi, në baza mujore të bëjë transferimin e mjeteve në bazë të faturës mujore çdo muaj për periudhën Shtator - Dhjetor 2020, duke respektuar ndarjen buxhetore të përcaktuar te nën-programi "Kompensimi i Kartonit të Gjëlber" me kod 29700.
4. Mjetet e ndara sipas pikës 1. si dhe mjetet që ndahen çdo muaj sipas pikës 3. të këtij vendimi, transferohen nga Thesari në llogarinë e veçantë bankare të Byrosë Kosovare të Sigurimit të përcaktuar në faturë, në baza mujore, në emër të pagesës së primit, në përputhje me nenin 4, paragrafi 4 i Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 30.07.2020.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kompensimi financiar i njehershëm për delegatët e legjislaturës 1990 të cilët kanë certifikuar mandatin e deputetit në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të datës 4 dhjetor 1999, të cilët kanë marrë pjesë në Mbledhjen e Kuvendit të Kosovës me datën 2 Korrik 1990 dhe me datën 7 shtator 1990, si dhe kanë vazhduar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit deri më datën 24 maj 1992.
2. Mjetet financiare të përcaktuara në Ligjin Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 në vlerë prej 287,000.00 euro do të ndahet proporcionalisht për njëqindpesë (105) deputetë sipas Gazetës Zyrtare nr. 21 e datë 3 Korrik 1990, në shume prej 2, 733.00 euro për secilin deputet.
3. Për ata deputet që nuk janë në jetë, kompensimin e plotë financiar të njehershëm, do e gëzojnë bashkëshortja/e veja e deputetit apo fëmija deri në moshën 18 vjeçare dhe nëse janë në studime deri në moshën 26 vjeçar, siç është përcaktuar në pikën dy (2) të këtij Vendimi.
4. Çdo vendim për kompensimin e kësaj kategorie të përfituesve duhet të jete i bazuar në ndarjen buxhetore të paraparë për këtë qëllim sipas Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.
5. Dokumenti në bazë të të cilit vërtetohet numri dhe identiteti (emri e mbiemri) i deputeteve që do ta gëzojnë kompensimin financiar të njehershëm, sipas pikës një (1) të këtij Vendimi është Gazeta Zyrtare nr. 21 e datës 3 Korrik 1990.
6. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah/HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Punimeve nga Metalet e Çmuara.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/31
Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Dërgimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë për vitin 2021.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/31

Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma për lidhjen e marrëveshjes për financimin dhe drejtimin e zbatimit të projektit Heras +/-Arsimi i Lartë, Hulumtim dhe Shkencë Aplikative në Kosovë ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim - ADA.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/31


Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma për lidhjen e Protokollit për ndryshim dhe shtesë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për Bashkëpunimin të Ndërsjellë në Fushën e Sigurisë .
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Punëve të Brendshme të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/31

Datë: 21.09.2020

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 42 (2) të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, nenin 16 (2) të Ligjit Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, nenin 14 (1) të Rregullores nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Shpen Trdevaj, emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HODI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi
- Arkivit të Qeverisë